




PËRMBLEDHJE POLITIKASH:

Rregullat për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave nga mediat dhe gazetarët në Shqipëri

Qershor 2023





PËRMBLEDHJE POLITIKASH:

Rregullat për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave nga mediat dhe gazetarët në Shqipëri

Qershor 2023

Publikuar nga: Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri
Rr. Nikolla Jorga, Nr. 8/8, Tiranë, Shqipëri
<http://birn.eu.com/>

Autor: Emirjon Marku

Redaktor gjuhësor: Marcus Tanner

Dizajni grafik: Jurgena Tahiri

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (Balkan Investigative Reporting Network in Albania - BIRN)
Tiranë, 2023

Pasqyra e lëndës:

I. PARATHËNIE	9
II. KUADRI LIGJOR NË SHQIPËRI	11
II.1 Përpunimi i të dhënave personale për qëllime gazetarie	18
II.2 Si t'i kuptojmë/zbatojmë përjashtimet	24
III. RREGULLORJA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE (GDPR)	27
IV. KONKULZIONE/KËSHILLA TË RËNDËSISHME	31

Komisioner

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Konventa nr. 108

Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, si dhe protokolle shtesë të saj të vitit 1981

Vendimi nr. 8

Vendimi nr. 8, datë 31 tetor 2016, i Komisionerit *“Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”*

Direktiva 95/46/EC

DIREKTIVA 95/46/EC E PARLAMENTIT DHE E KËSHILLIT, e datës 24 tetor 1995, për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave

KEDNJ

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

ZEE (EFTA)

Zona Ekonomike Evropiane

BE

Bashkimi Evropian

Komisioni i BE

Komisioni i Bashkimit Evropian

GDPR

RREGULLORJA (e BE) 2016/679 E PARLAMENTIT DHE E KËSHILLIT e datës 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave, si dhe për shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave)

Udhëzimi nr. 9

Udhëzimi nr. 9, datë 15.09.2010, i Komisionerit *“Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”*

Udhëzimi nr. 31


Udhëzimi nr. 31, datë 27.12.2012, i Komisionerit *“Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike”*

Udhëzimi nr. 41

Udhëzim nr. 41, datë 13.06.2014, i Komisionerit *“Për lejimin e disa kategorive të transferimeve ndërkombëtare të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”*

Ligj për Mbrojtjen e të Dhënave

Ligji nr. 9887, datë 10.08.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar



I. PARATHËNIE

Fusha e gazetarisë paraqet një mikrokozmos unik në lidhje me të drejtën e qytetarëve për mbrojtjen e të dhënave të personale dhe privatësi.

Oreksi gazetaresk për informacione personale voluminoze, të mbledhura gjatë punës së përditshme (p.sh., në intervista, investigime, raportime, fotografi, etj.) sfidohet nga e drejta e subjekteve të të dhënave (qytetarëve) për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë së tyre.

Në të vërtetë, si liria e shprehjes, e personifikuar sidomos në veprimtarinë gazetarisë, ashtu edhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë përbëjnë kategori të drejtash kushtetuese të parashikuara, përkatësisht, në nenet 22 dhe 35 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Këto të drejta janë, gjithashtu, të garantuara në të njëjtin nivel normativ nëpërmjet Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), në të cilën Shqipëria është palë (bazuar në nenet 8 dhe 10 të saj).

Çdo individ gëzon të drejtën për një jetë private të sigurt dhe të mbrojtur, si dhe për të ushtruar kontroll mbi përpunimin e të dhënave personale të tij/saj, nga kontrolluesit përkatës (përfshirë organizatat e medias dhe gazetarët e pavarur (*freelancers*)).

Nga ana tjetër, gazetaria luan një rol të pashmangshëm në formimin e një opinioni publik të informuar, si dhe në mbështetjen e një shoqërie demokratike.

Gazetarët janë përgjegjës për përhapjen e informacionit dhe informimin e publikut në lidhje me çështje të interesit publik, të cilat vetë publiku ka të drejtë t'i dijë.

Megjithatë, roli thelbësor i gazetarisë në jetën e një shoqërie demokratike, si mbikëqyrës publik (i ashtuquajtur *“pushtet i katërt”*), ndonjëherë prodhon konflikt midis lirisë së shprehjes dhe të drejtës për privatësi.

Kjo përplasje duhet të adresohet posaçërisht, në çdo rast specifik.

Pyetja se kur të drejta e privatësisë prevalon mbi lirinë e shprehjes, si dhe anasjelltas, është trajtuar nga perspektiva ligjore – edhe pse jo në mënyrë shteruese – nga legjislati për mbrojtjen e të dhënave personale në Shqipëri (në kuadër të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe akteve nënligjore të tij) dhe GDPR-së (në BE).

Bazuar në sa parashtruar më sipër, ky dokument synon të tërheqë vëmendjen dhe t'i shpjegojë lexuesve (gazetarë, redaktorë, drejtues mediatikë, etj.) kufijtë e bashkëekzistencës së këtyre lirive dhe të drejtave kushtetuese në Shqipëri – për t'i ndihmuar ata të kuptojnë si të arrijnë balancën e nevojshme, midis këtyre të drejtave kushtetuese, gjatë ushtrimit të profesionit të tyre.

Një seksion i veçantë i dedikohet zhvillimeve ligjore në BE në kuadër të GDPR-së.

Lutemi, mbani parasysh se ky dokument synon kryesisht të ofrojë një udhërrëfyes për respektimin e parimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë edhe disa konsiderata etike. Ky dokument nuk përmban zgjidhje shteruese për arritjen e përputhshmërisë ligjore me detyrimet që burojnë nga liria e shprehjes dhe e drejta për mbrojtjen e të dhënave/privatësisë.

II. KUADRI LIGJOR NË SHQIPËRI

Instrumenti kryesor i legjislacionit shqiptar që trajton në detaje të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale në Shqipëri është Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave, së bashku me aktet nënligjore të miratuara nga Komisioneri, i cili është autoriteti kompetent që mbikëqyr përputhshmërinë e kontrolloruesve dhe/ose përpunuesve të të dhënave me legjislacionin në fuqi.

Dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave zbatohen për përpunimin e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave (qytetarëve/individëve), të kryer nga kontrolluesit/përpunuesit përkatës me mjete automatike ose të tjera.

Ligji në fjalë zbatohet, ndër të tjera, ndaj kontrolluesve të vendosur në Republikën e Shqipërisë, si dhe kontrolluesve që nuk janë të vendosur në vend, por që përdorin, për qëllime të veprimtarisë së tyre, mjete të vendosura në Republikën e Shqipërisë.

Pika 1 e nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave përcakton se të dhënat personale përfshijnë çdo informacion në lidhje me një individ, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social.

Për shembull, të dhëna personale janë, pa kufizim, emri, mbiemri, adresa, imazhi/fotografia/sekuenca filmike, mosha, shenjat e gishtërinjve, zëri, numri i telefonit, emaili, jetëshkrimi (CV), protokollin e internetit (IP), ose llogaria në media sociale, etj., që i përkasin një subjekti të dhënash/individit.

Përpunimi i të dhënave personale përfshin, por nuk kufizohet në, mbledhjen, regjistrimin, organizimin, ruajtjen, përshtatjen ose ndryshimin, transmetimin, zbulimin, fshirjen ose shkatërrimin, etj., e të dhënave personale.

Secili prej këtyre veprimeve përbën në vetvete një përpunim të dhënash personale.

Përpunimi i të dhënave personale kryhet nga kontrolluesi dhe/ose përpunuesi i të dhënave.

Kontrollues të dhënash është person fizik ose juridik që përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse. Shoqëritë/organizatat mediatike ose gazetarët e pavarur (*freelancers*) mund të konsiderohen si kontrollues të dhënash.

Përpunues të dhënash është çdo person fizik ose juridik që përpunon të dhënat personale në emër të kontrolluesit. Gazetarët e punësuar mund të konsiderohen si përpunues të dhënash, që veprojnë në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit (organizatës mediatike), i cili i ka punësuar ata.

Çdo kontrollues/përpunues duhet të njoftojë Komisionerin nëpërmjet një formulari standard njoftimi, në lidhje me veprimtarinë e tij përpunuese, para fillimit të veprimtarisë së përpunimit të të dhënave, ose sa herë ndryshon kjo veprimtari (neni 21 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale). Ky njihet si *detyrimi për njoftim*.

Parimet

Me qëllim respektimin e legjislacionit të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave, një kontrollues/përpunues duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 5 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave.

- *'Përpunim i ligjshëm dhe i drejtë'*

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale nënkupton detyrimin e një kontrolluesi për të përpunuar të dhëna personale vetëm bazuar në një kriter ligjor të caktuar. Një kriter i tillë mund të jetë pëlqimi i subjektit të të dhënave, lidhja e një marrëdhënieje kontraktore, përmbushja e një detyrimi ligjor, interesi legjitim, etj. (shih gërmat (a) deri (f) më poshtë).

Në këtë kontekst, një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet kriterit ligjor të përpunimit të të dhënave sensitive, si dhe të dhënave të fëmijëve; ato gëzojnë mbrojtje të veçantë nga legjislacioni në fuqi.

Nga ana tjetër, përpunimi i drejtë i të dhënave personale nënkupton marrjen në konsideratë të pritshmërive për privatësi të subjekteve të të dhënave ndërsa mbledhen/përpunohen të dhënat e tyre, pa i çorientuar ata për këtë qëllim, ose duke mbledhur/përpunuar të dhëna personale në një mënyrë që të mos shkaktojë pasoja të pajustificueshme për subjektin e të dhënave/individin.

Kjo do të thotë se kontrolluesi duhet të sigurojë që subjektet e të dhënave trajtohen në mënyrë të drejtë, kur ata kërkojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre; këto të drejta përfshijnë të drejtën e aksesit në të dhënat, të drejtën për bllokim, korrigjim, fshirje, kundërshtim të përpunimit, etj.

- *'Kufizimi i qëllimit'*

Ky parim nënkupton që mbledhja e të dhënave personale duhet të realizohet për qëllime specifike, të përcaktuara qartë dhe të ligjshme, si dhe përpunimi (i mëtejshëm) i të dhënave duhet të jetë, gjithashtu, në përputhje me qëllimet në fjalë.

Për shembull, nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime gazetarie (gjatë një interviste, etj.), këto të dhëna nuk mund të përpunohen më tej nëse qëllimi i ri ndryshon

nga i pari (d.m.th. për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë) – i ashtuquajtur “*zgjerim funksioni*” (*function creep*).

Nëse qëllimi i ri nuk është i pajtueshëm me atë të mëparshëm, përpunimi i mëtejshëm i të dhënave duhet të bazohet sërish në një kriter ligjor të ri (d.m.th., pëlqim, interes legjitim, etj. – shih shkronjat (a) deri (f) më poshtë).

Transparenca në lidhje me qëllimin e përdorimit të të dhënave personale, u mundëson individëve të kenë një kuptim të qartë të qëllimeve dhe veprimeve që lidhen me informacionin e tyre personal. Kjo qartësi bën të mundur që ata të marrin vendime të informuara, përfshirë nëse do të ndajnë, ose jo, të dhënat e tyre me ju.

Gjithashtu, transparenca u mundëson individëve të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kenë kontroll më të madh mbi përpunimin e të dhënave personale përkatëse.

- ‘*Minimizimi i të dhënave*’

Ky parim nënkupton që, për të arritur qëllimin e përpunimit, kontrolluesi duhet të përpunojë vetëm ato të dhëna personale që janë të mjaftueshme për qëllimin në fjalë. Këto informacione/të dhëna personale duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit të tyre dhe të mos jenë të tepërta në lidhje me të.

Nëse mbledhni të dhëna personale përtej asaj që është e nevojshme për të përmbushur qëllimin e synuar nga ju, individët mund të ushtrojnë të drejtën për të kërkuar fshirjen e të dhënave të tyre personale (*e drejta për fshirje*). Në të kundërt, nëse mbani të dhëna të pamjaftueshme, mund të përballeni me sfida në lidhje me përçimin e një kuptimi gjithëpërfshirës të fakteve përkatëse. Në këto raste, individët kanë të drejtë të kërkojnë plotësimin e çdo të dhëne të paplotë (*e drejta për korrigjim*).

- ‘*Saktësia*’

Parimi i saktësisë nënkupton që të dhënat personale duhet të jenë të sakta, të plota dhe, kur është e nevojshme, të përditësohen; duhet ndërmarrë çdo hap i arsyeshëm për të fshirë, plotësuar ose korrigjuar çdo të dhënë të pasaktë ose jo të plotë, duke pasur parasysh qëllimet për të cilat ato janë mbledhur ose për të cilat ato përpunohen më tej. Shfrytëzimi i saktë i të dhënave, përveçse përbën një parim shumë të rëndësishëm ligjor për qëllime të mbrojtjes së të dhënave, është vendimtar edhe për punën gazetareske. Ruajtja e besimit të publikut, duke përdorur informacione të sakta personale, mbron interesin e rëndësishëm publik, i cili është në thelb të vetë gazetarisë, si dhe mund të rrisë reputacionin e një organi mediatik si një burim i besueshëm lajmesh. Është veçanërisht e rëndësishme, për ruajtjen e saktësisë së të dhënave, që të bëhet dallimi midis fakteve dhe opinionëve kur shpërndahet informacioni në lidhje me individët; vëmendje e konsiderueshme duhet t’i kushtohet burimit të informacionit (përdorimi i burimeve të internetit, mediave sociale dhe përmbajtjeve të tjera, të gjeneruara nga përdoruesit, bart një nivel potencialisht të lartë

rreziku sa i përket saktësisë së informacionit).

- *'Mbajtja e kufizuar në kohë'*

Të dhënat personale duhet të mbahen në një formë që lejon identifikimin e individëve jo më gjatë sesa është e nevojshme për të arritur qëllimet për të cilat të dhënat mbledhen ose përpunohen më tej.

Legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave nuk parashikon kufizime kohore të shprehura për kategori të ndryshme të dhënash. Prandaj, është detyrë e vetë kontrolluesit të vlerësojë qëllimin për të cilin përpunon të dhënat personale, si dhe të përcaktojë në mënyrë të arsyeshme periudhën e duhur kohore për ruajtjen e këtyre të dhënave.

Kur vendoset për një periudhë kohore, të përshtatshme, ruajtjeje të të dhënave, është thelbësore të merret parasysh qëllimi specifik që qëndron pas përpunimit të të dhënave personale. Duke kryer një vlerësim të plotë, ju mund të përcaktoni një kornizë të arsyeshme kohore për ruajtjen e të dhënave, e cila përputhet me qëllimin tuaj dhe siguron respektimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave.

Kriteret ligjore

Në bazë të nenit 6 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave, përpunimi i të dhënave personale konsiderohet i ligjshëm vetëm nëse kryhet në përputhje me kriteret/bazat ligjore të mëposhtme:

- (a) Nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij/saj për përpunimin e të dhënave personale;
- (b) Nëse përpunimi i të dhënave personale është thelbësor për përmbushjen e një kontrate të lidhur nga subjekti i të dhënave, ose për diskutime ose ndryshime të një projekti/kontratë me propozimin e subjektit të të dhënave;
- (c) Për mbrojtjen e interesit jetik të subjektit të të dhënave;
- (d) Për përmbushjen e një detyrimi ligjor të kontrolluesit;
- (e) Për kryerjen e një detyre ligjore me interes publik ose ushtrimin e një kompetence të kontrolluesit ose të një pale të tretë, së cilës i janë përhapur të dhënat;
- (f) Nëse përpunimi i të dhënave është thelbësor për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave

legjitime të kontrolluesit, marrësit të të dhënave apo personave të tjerë të interesuar, por me kusht që ky interes legjitim të mos jetë në kundërshtim me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private.

Në praktikë, kriteret ligjore që zakonisht zbatohen për përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie janë:

- *Pëlqimi*: Kur individët kanë dhënë pëlqimin e shprehur dhe të informuar për përpunimin e të dhënave të tyre personale për qëllime gazetarie, pëlqimi mund të shërbejë si kriter i ligjshëm për përpunim. Është e rëndësishme të sigurohet që pëlqimi të jepet lirisht, në mënyrë specifike dhe të mund të tërhiqet në çdo kohë.
- *Përmbushja e një detyrimi ligjor*: Përmbushja e një detyrimi ligjor, të cilit i nënshtrohet një organizatë mediatike, mund të shërbejë si kriter i ligjshëm për përpunimin e të dhënave personale. Kjo mund të përfshijë detyrime të vendosura nga ligjet ose rregulloret që normojnë veprimtaritë mediatike.
- *Interesi legjitim*: Ky kriter kërkon një vlerësim të kujdesshëm të interesave dhe të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe sigurimin që të drejtat dhe liritë themelore të individëve të mos prevalojnë mbi interesat legjitime të organizatës mediatike. Për këtë qëllim nevojitet një test balancimi që të vlerësohet nëse interesi legjitim (p.sh., interesi publik) mbi një publikim të caktuar të një lajmi prevalon ndaj të drejtës së individit për privatësi.

Të dhënat sensitive

Një trajtim i veçantë i rezervohet përpunimit të të dhënave sensitive, siç përcaktohet në nenin 7 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këtu përfshihet çdo informacion që lidhet me një individ, i cili ka të bëjë me **origjinën e tij/saj racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësinë në sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimet penale**, si dhe të dhëna që lidhen me **shëndetin dhe jetën seksuale**.

Përpunimi i të dhënave sensitive mund të bëhet, ndër të tjera: nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij/saj me shkrim; nëse është në interesin jetik të këtij të fundit ose të një personi tjetër (kur subjekti i të dhënave është i paaftë fizikisht ose mendërisht për të dhënë pëlqimin); nëse autorizohet nga autoriteti kompetent për arsye të interesit publik; nëse ka të bëjë me të dhëna personale të bëra haptazi publike nga subjekti i të dhënave ose është i nevojshëm për ushtrimin ose mbrojtjen e një të drejte ligjore; ose nëse kërkohet për qëllime të mjekësisë parandaluese, kujdesit shëndetësor, etj.

Pa paragjykuar sa më sipër, gjasat më të mëdha janë që përpunimi i të dhënave sensitive për qëllime gazetarie të bazohet në kriteret ligjore si vijon:

- *Pëlqimi i shprehur*: Marrja e pëlqimit të shprehur të subjektit të të dhënave është

përgjithësisht kriteri ligjor më i besueshëm dhe i përshtatshëm për përpunimin e të dhënave sensitive. Gazetarët duhet të sigurojnë që pëlqimi të merret lirisht dhe që individët të jenë plotësisht të informuar për qëllimin dhe objektivin e përpunimit të të dhënave.

- *Interesi thelbësor publik*: Përpunimi i të dhënave sensitive mund të justifikohet nëse është i nevojshëm për arsye të interesit thelbësor publik, siç është gazetaria investigative ose raportimi për çështje të shqetësimit/interesit publik. Kjo kërkon gjithashtu masa të përshtatshme për të siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të subjekteve, të dhënat e të cilëve përpunohen.

Është e rëndësishme të theksohet se kur përpunohen të dhëna sensitive, për qëllime gazetarie, duhet të ekzistojnë masa mbrojtëse shtesë dhe një vëmendje e shtuar për të siguruar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të individëve.

Gazetarët dhe organizatat mediatike duhet të respektojnë detyrimet që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave, kodet profesionale të sjelljes dhe udhëzimet etike specifike për juridiksionin/industrinë e tyre. Gjithashtu, zbatimi i masave të duhura të sigurisë, si dhe garantimi i parimit të minimizimit të të dhënave, është thelbësor për sigurinë e të dhënave sensitive.

Transferimi ndërkombëtar

Si rregull, transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale lejohet të bëhet drejt shteteve që kanë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, siç përcaktohet me Vendimin nr. 8 dhe Udhëzimin nr. 41 të Komisionerit, në harmoni me nenin 8 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Lista e vendeve që kanë një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale përfshin, ndër të tjera, shtetet anëtare të BE-së, shtetet anëtare të ZEE (EFTA), palët në Konventën nr. 108, si dhe vendet e përcaktuara me vendim të Komisionit të BE-së.

Lejohet transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale drejt vendeve pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale (neni 8 i ligjit), ndër të tjera: me pëlqimin e subjektit të të dhënave; për mbrojtjen e interesave jetike të këtyre të fundit; për arsye të interesit publik ose mbrojtjes së një të drejte ligjore; ose nëse të dhënat përpunohen nga një regjistër i aksesueshëm për qëllime konsultimi dhe që ofron informacion për publikun në përgjithësi. Në raste të tjera, transferimi i të dhënave personale mund të kryhet vetëm me autorizim të Komisionerit (neni 9 i ligjit).

Veçanërisht të rëndësishme, në kontekstin e përpunimit të të dhënave personale, janë të drejtat e subjektit të të dhënave të parashikuara në dispozitat e neneve 12-18 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ato përfshijnë:

(i) *Të drejtën për akses.* Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të marrin, pa pagesë, nga kontrolluesi i të dhënave (sipas kërkesës me shkrim), konfirmimin nëse të dhënat e tyre personale janë duke u përpunuar, informacionin mbi qëllimet e përpunimit, si dhe për kategoritë e të dhënave të përpunuara dhe marrësit, të cilëve iu zbulohen/shpërndahen të dhënat personale.

Megjithatë, kjo e drejtë mund të ushtrohet, ndër të tjera, vetëm nëse është në përputhje me lirinë e shprehjes/shtypit dhe sekretin profesional. Kur refuzohet e drejta e aksesit, kontrolluesi duhet që brenda 30 ditëve të shpjegojë arsyen e një refuzimi të tillë dhe të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën e tij për të paraqitur një ankesë pranë Komisionerit, i cili ka të drejtë të kontrollojë (me kërkesë të subjektit të të dhënave) nëse refuzimi i të drejtës për akses justifikohet nga arsyet në fjalë;

(ii) *Të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave.* Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave të tij, pa pagesë, sa herë që vihet në dijeni se të dhënat në lidhje me të janë të pasakta, të pavërteta dhe të paplota, ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit;

(iii) *Të drejtën për të kundërshtuar përpunimin.* Subjekti i të dhënave ka të drejtë të kundërshtojë përpunimin e të dhënave të tij personale nga kontrolluesi përkatës, nëse kriter ligjor për një përpunim të tillë është ose kryerja e një detyre ligjore me interes publik ose interesi legjitim i kontrolluesit ose i një pale të tretë. Për këtë qëllim, subjekti i të dhënave duhet të mbështetet në dispozitat përkatëse të legjislacionit në fuqi që i japin të drejtën atij/asaj të kundërshtojë një përpunim të tillë;

(iv) *Të drejtën për t'u ankuar.* Çdo person, i cili pretendon se i janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme në lidhje me të dhënat personale, ka të drejtë të ankohet ose të njoftojë Komisionerin dhe të kërkojë ndërhyrjen e tij për të korrigjuar të drejtën e shkelur.

Subjektet e të dhënave mund t'i drejtohen gjykatës dhe të kërkojnë shpërblimin e dëmit të pësuar, si rezultat i përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale.

Më tej, në bazë të nenit 18 të ligjit, kur mbledh dhëna personale, kontrolluesi është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave, ndër të tjera, për: emrin e kontrolluesit; qëllimin e përpunimit të të dhënave personale; personin që do të përpunojë të dhënat personale dhe mjetet e përpunimit në fjalë; personat ose kategoritë e personave të cilëve do t'u transmetohen/zbulohen të dhënat personale; të drejtën e subjektit të të dhënave

për të aksesuar dhe korigjuar të dhënat personale; periudhën e ruajtjes së të dhënave personale, etj.

E drejta e subjektit të të dhënave për informim përkon me detyrimin e kontrolluesit për të realizuar këtë informim. Informimi i subjektit të të dhënave i paraprin pëlqimit të tij/saj për përpunimin e të dhënave personale (*pëlqimi i informuar*).

II.1 Përpunimi i të dhënave personale për qëllime gazetarie

Duke pasur parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe, veçanërisht, gazetarinë si instrument për sigurimin e saj, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave i kushton vëmendje të veçantë përpunimit të të dhënave personale për qëllime gazetarie, duke e konsideruar atë një veprimtari të veçantë përpunimi.

Në këtë këndvështrim, bazuar në nenin 11 të ligjit, Komisioneri përcakton, në bazë të një udhëzimi specifik, kushtet dhe kriteret kur kontrolluesit (organizatat mediatike/gazetarët e pavarur) përjashtohen nga detyrimet e parashikuara në ligj, në lidhje me parimet e përpunimit (neni 5), kriteret ligjore të përpunimit (neni 6), përpunimin e të dhënave sensitive (neni 7), transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale (neni 8), detyrimin për informimin e subjektit të të dhënave (neni 18) , si dhe detyrimin për njoftimin e Komisionerit për veprimtarinë përpunuese (neni 21).

Këto përjashtime lejohen deri në masën që ato pajtojnë të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale me rregullat që normojnë lirinë e shprehjes.

Për këtë qëllim, neni 11 (pika 3) i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale parashikon detyrimin që organizatat mediatike të kenë akte specifike vetërregulluese (të detyrueshme), si kodet e etikës/sjelljes, me qëllim të përcaktimit dhe përcaktimin e politikave dhe rregullave rreth veprimtarive të përpunimit të të dhënave personale për qëllime gazetarie.

Nisur nga sa më sipër, Komisioneri ka miratuar Udhëzimin nr. 9 dhe Udhëzimin nr. 31. Këto udhëzime janë akte nënligjore të detyrueshme, të cilat synojnë të përcaktojnë dhe qartësojnë perimetrin e përjashtimeve të përcaktuara në nenin 11 të ligjit, si dhe të ofrojnë siguri juridike, si për kontrolluesit (organizatat e medias/gazetarët e pavarur), ashtu edhe për subjektet e të dhënave, në kuadër të veprimtarive të përpunimit të të dhënave për qëllime gazetarie.

II.1.1 Udhëzimi nr. 9

Objekti i këtij instrumenti është të përcaktojë rregullat për përpunimin e të dhënave personale nga organet mediatike publike dhe private (media e shkruar, vizuale dhe

audiovizive).

Udhëzimi nr. 9 thekson se e drejta për mbrojtjen e të dhënave nuk duhet të shfaqet si një pengesë dytësore për të drejtën e gazetarëve për liri shprehjeje.

Për këtë qëllim, organet mediatike duhet të kujdesen që të mos publikojnë informacione të pasakta, mashtruese ose të shtrembëruara, përfshirë fotografi (*parimi i saktësisë*).

Gazetari, përveç publikimit të thelbit të informacionit, nuk duhet të publikojë lajme apo fotografi të personave të përfshirë në ngjarje që cenojnë dinjitetin e personit. Gazetari, gjithashtu, nuk duhet të ndalet në detaje dhune, nëse nuk e konsideron atë si lajm ose imazh me interes publik. Gazetari nuk duhet të marrë ose të prodhojë imazhe dhe fotografi të personave në gjendje të ndaluar/arrestuar, pa pëlqimin e tyre, përveç rasteve kur këto imazhe/fotografi janë me interes të rëndësishëm publik, ose për qëllime të justifikuara drejtësie dhe policore.

Mediat duhet të mbajnë parasysh të drejtën e individit për një jetë private dhe familjare, si dhe fshehtësi korrespondence (përfshirë komunikimin digjital). Asnjë ndërhyrje në jetën private të një personi nuk lejohet pa pëlqimin e tij/saj. Gjithashtu, publikimi i fotografive të individëve në vende private, pa pëlqimin e tyre, është i ndaluar. Gazetarët nuk mund të hyjnë me forcë në shtëpinë e dikujt ose të marrin imazhe nga një mjedis privat.

Gjatë mbledhjes së të dhënave personale/sensitive, për qëllime gazetarie, gazetarët duhet të vlerësojnë – duke pasur parasysh rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale – se cilat informacione mund të cenojnë dinjitetin dhe personalitetin e qytetarit, me qëllim që të shmangët publikimi i tyre. Publikimi nuk duhet të përmbajë një informacion të gjerë, përveç nëse është me interes publik. Në çdo rast, përgjegjësia për arritjen e një balancimi midis privatësisë dhe interesit publik bie mbi gazetarin që publikon të dhënat.

Krahas rregullave të përgjithshme, Udhëzimi nr. 9 i kushton vëmendje të veçantë përpunimit të të dhënave personale të të miturve, si dhe hetimeve penale, përgjimit, të dhënave shëndetësore, publikimit të fotografive, personave publikë, si dhe rrethanave që përcaktojnë interesin publik.

Të miturit

Të miturit, si individë vulnerabël dhe më pak të mbrojtur, përballen me një rrezik të lartë të shkeljes së të drejtave të tyre themelore – përfshirë të drejtën për privatësi.

Të miturit nën moshën 16 vjeç nuk duhet të intervistohen ose fotografohen për çështje që kanë të bëjnë me mirëqenien ose sjelljen e tyre, ose të një fëmije tjetër, përveç nëse prindi kujdestar jep pëlqimin për këtë qëllim. Nxënësit nuk duhet të fotografohen apo intervistohen në shkollë pa lejen e autoriteteve shkollore. Gazetarët, gjithashtu, nuk duhet

të përdorin famën ose pozitën e një prindi si justifikim për të publikuar detaje të jetës private të një të mituri.

Për të mbrojtur personalitetin e të miturit, gazetari nuk duhet të publikojë emrin e tij/saj, ose të japë detaje që mund të çojnë në identifikimin e tyre. Ndalohet publikimi dhe shpërndarja e detajeve, lajmeve ose fotografive për të identifikuar një të mitur të përfshirë në një krim dhe/ose si viktima apo dëshmitarë të krimeve, përfshirë krimet seksuale. Veçanërisht, gjatë raportimit të një krimi seksual, gazetari nuk mund të publikojë identitetin e të miturit ose të nënkuptojë marrëdhënien midis autorit dhe të miturit. E drejta e të miturit për privatësi, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një rast abuzimi, mbizotëron gjithmonë ndaj çdo të drejte raportimi/regjistrimi/transmetimi. Kjo vlen edhe kur identiteti i fëmijës bëhet i ditur nga burime zyrtare ose nga burime pranë familjes së të tij/saj.

Mbrojtja e të miturve nga përhapja e të dhënave të identifikimit dhe nga ekspozimi i të dhënave të jetës seksuale (*të dhënave sensitive*), është thelbësor dhe mbizotëron ndaj lirisë së shtypit. Kjo e fundit mund të ushtrohet me të njëjtin efektivitet edhe pa raportuar emrin dhe mbiemrin, apo të dhëna të tjera identifikuese të të miturit.

Mbrojtja në procedime penale

Kur raportohet një krim, të afërmit ose miqtë e personave të dënuar ose të akuzuar nuk duhet të identifikohen pa pëlqimin e tyre.

Gazetarët janë përgjegjës për publikimin e informacionit të plotë, të saktë dhe të përditësuar (*parimi i saktësisë*). Në çdo rast, garancitë themelore të të akuzuarit duhet të respektohen para çdo dyshimi për fajësi, deri në një vendim gjyqësor, dënimi, të formës së prerë (*prezumimi i pafajësisë*).

Nga ana tjetër, gazetarët mund të raportojnë, kur është në interes të publikut, akuza që mund të vijë nga një palë e tretë, edhe kur është e vështirë që këto akuza të mbështeten në burime policore, ose nga një procedurë policore (si p.sh., ndalimi). Publikimi i materialit gazetaresk, në këto rrethana, nuk duhet të identifikojë personin e akuzuar.

Gazetarët duhet të respektojnë jetën private, të drejtat, pronën, shëndetin dhe fshehtësinë e korrespondencës së të akuzuarit ose të dënuarit.

Është thelbësore të respektohet parimi i prezumimit të pafajësisë, çfarë nënkupton detyrimin që publikimi i informacionit për një procedim penal, në vijim e sipër, të bëhet pa cënuar parimin në fjalë.

Personat e dyshuar, të akuzuar apo të dënuar, në parim, gëzojnë të drejtën e privatësisë, sipas nenit 8 të KEDNJ.

Identiteti i dëshmitarëve nuk duhet të bëhet i ditur, përveç kur (i) këta persona kanë dhënë më parë pëlqimin e tyre, (ii) identifikimi i dëshmitarëve është me interes publik, ose (iii) dëshmia përkatëse është bërë publike më parë.

Përgjimi

Udhëzimi nr. 9, në parim, ndalon përpunimin e të dhënave personale –përfshirë publikimin e materialit (gazetaresk) – të marrë nëpërmjet përdorimit të kamerave të fshehta ose pajisjeve të tjera të fshehta të dëgjimit, ose nga telefonatat privatë ose celulare, mesazhet ose emailt, ose nëpërmjet marrjes së paautorizuar të dokumenteve ose fotografive që përmbajnë të dhëna personale.

Publikimi dhe/ose shpërndarja – kundër vullnetit të subjektit të të dhënave – e fotografive të shkrepura nga policia, për qëllime dokumentimi dhe hetimi, nuk duhet të kryhet pa ekzistencën e kushteve të veçanta që përfshihen në perimetrin e interesit publik.

Nga ana tjetër, edhe në prani të një fakti me interes publik, publikimi i të dhënave të përpunuara nga përgjimet telefonike duhet të respektojë parametrat e thelbit të informacionit. Elementë informacioni që përmbajnë aspekte rreptësisht personale, ose që lidhen me sferën seksuale të një individi, nuk duhet të publikohen. Gazetarët nuk duhet të publikojnë tekste mesazhesh dhe/ose biseda telefonike që kanë të bëjnë me jetën private të të subjektit të të dhënave, raportet e tyre personale apo interesat profesionale.

Mbrojtja e të dhënave shëndetësore

Kufizimet për ndërhyrjet në jetën private janë veçanërisht të rëndësishme për publikimet gazetareske, objekt i të cilave janë personat të shtruar në institucionet shëndetësore. Të dhënat shëndetësore janë të dhëna sensitive dhe nuk duhet të publikohen pa marrë pëlqimin e subjektit përkatës, përveç nëse pacienti nuk identifikohet dhe detajet që mund të çojnë në identifikimin e tij/saj nuk përshkruhen në materialin e publikuar.

Gazetarët duhet të respektojnë dinjitetin dhe të drejtën e privatësisë së individit, veçanërisht në rastet e sëmundjeve të rënda, duke shmangur, në këtë mënyrë, publikimin e detajeve të panevojshme.

Publikimi i fotografive

Gjatë dokumentimit fotografik të një fakti, objekt kronike gazetari, gazetari/fotografi duhet të vlerësojë se çfarë lloj fokusimi duhet zgjedhur, me qëllim që të shmangët fokusimi

i imazheve vetëm mbi individët, nëse shpërndarja e këtyre të dhënave (imazheve) nuk rezulton të jetë e lidhur me, ose e tejkalon, qëllimin e kronikës përkatëse.

Pamjet/imazhet që dokumentojnë arrestimin e një individi nuk mund të shpërndahen kur mund të cenojnë dinjitetin e atij individi. Ndalohet riprodhimi i imazheve të personave në paraburgim, me përjashtim të rasteve kur kjo përbën interes publik.

Personat publikë

Jeta private e personave të njohur, apo që ushtrojnë funksione publike, duhet të respektohet. Asnjë e dhënë për familjarët, miqtë, të njohurit apo të miturit e tyre nuk duhet të publikohet, nëse lajmet/kronikat përkatëse nuk kanë të bëjnë me jetën publike të këtyre personave publikë.

Më tej, gazetarët mund të shkruajnë për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të një personi publik, pa u ndalur në detaje të sëmundjes përkatëse, veçanërisht në rastet e sëmundjeve të rënda, duke shmangur kështu publikimin e të dhënave që janë rreptësisht të natyrës klinike, si dhe që nuk i shërbejnë qëllimit të kronikës/reportazhit përkatës.

Interesi publik

Udhëzimi nr. 9 nuk parashikon një përkufizim specifik të interesit publik. Ai liston vetëm rrethanat në të cilat interesi publik mund të jetë i qenësishëm (Kreu IX i udhëzimit). Të tilla rrethana përfshijnë, ndër të tjera, sigurinë kombëtare, integritetin territorial dhe sigurinë publike, parandalimin e trazirave ose krimeve, mbrojtjen e shëndetit dhe moralit, parandalimin publik të veprimeve mashtruese të individëve, mbrojtjen e reputacionit/dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, etj.

Gjatë përpunimit të të dhënave personale për qëllime gazetarie, gazetari duhet të marrë parasysh rrethanat e sipërpërmendura, ndërsa vlerëson nëse publikimi i një informacioni përbën interes publik.

Për këtë qëllim, kriteret e përjashtimit të përcaktuara në Udhëzimin nr. 31 synojnë t'i ndihmojnë gazetarët që të vlerësojnë më objektivisht, nëse përgatitja dhe publikimi i një artikulli të caktuar mund të mbështetet tërësisht në interesin publik, ose nëse ka nevojë të mbështetet në një kriter tjetër ligjor (p.sh., pëlqimi, interesi legjitim, etj.), në mënyrë që të jetë në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave/privatësinë.

II.1.2 Udhëzimi nr. 31

Ndryshe nga Udhëzimi nr. 9, i cili ka një përmbajtje përshtetëse – hera-herës përsëritëse – Udhëzimi nr. 31 përcakton kriteret bazë për përjashtimin e përpunimit të të dhënave personale për qëllime gazetarie nga zbatimi i parimeve të privatësisë (neni 5), kritereve ligjore të përpunimit (neni 6), përpunimi i të dhënave sensitive (neni 7), transferimi ndërkombëtar i të dhënave (neni 8), detyrimi për informimin e subjektit të të dhënave (neni 18), si dhe detyrimi për njoftimin e veprimtarisë së përpunimit (neni 21).

Ky instrument përcakton se kërkesat e përjashtimit zbatohen për të gjithë kontrolluesit/ persona fizikë (d.m.th. gazetarët e pavarur) ose persona juridikë (d.m.th. organizatat mediatike), të cilët përpunojnë të dhëna personale në kuadër të veprimtarisë së tyre të gazetarisë.

Në këtë këndvështrim, përpunimi i të dhënave personale përjashtohet nga detyrimet ligjore të mësipërme për mbrojtjen e të dhënave, nëse kontrolluesi (organizata mediatike/ gazetari i pavarur) plotëson kriteret kumulative të mëposhtme:

- (i) Përpunimi kryhet me qëllim publikimi materialesh gazetarie, për të cilat të dhënat personale përkatëse janë të nevojshme;
- (ii) Publikimi i materialit të gazetarisë është me interes publiku; dhe
- (iii) Përmbushja e detyrimit specifik për mbrojtjen e të dhënave bie ndesh me qëllimin e synuar të përpunimit për qëllime gazetarie.

Megjithatë, sipas këtij udhëzimi, media përkatëse duhet të përmbushë detyrimet e saj për mbrojtjen e të dhënave, pa u mbështetur në përjashtimet e sipërpërmendura, nëse kjo është e mundur të arrihet.

Kjo e bën përjashtimin nga detyrimet për mbrojtjen e të dhënave personale një opsion të fundit (*ultima ratio*) dhe jo një rregull parimor të përpunimit të të dhënave personale për qëllime gazetarie.

Bazuar në dispozitat e Udhëzimit nr. 31, kontrolluesi (në të gjitha rastet), kur mbështetet në përjashtimet e sipërpërmendura, duhet të respektojë edhe detyrimet e mëposhtme:

- (a) Të dhënat personale duhet të ruhen vetëm për aq kohë sa ato i shërbejnë qëllimit të gazetarisë;
- (b) Të dhënat personale nuk duhet të shpërndahen në forma të tjera të ndryshme nga materiali i gazetarisë, ose te persona të ndryshëm nga marrësit që ndihmojnë në

përgatitjen e tij;

- (c) Të dhënat personale nuk duhet të përpunohen (më tej) për qëllime të tjera përpunimi, të cilat ndryshojnë nga qëllimi i gazetarisë;
- (d) Asnjë informacion identifikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i të miturve nuk duhet të reflektohet në materialin e përgatitur, përveç nëse autorizohet nga prindi/kujdestari ligjor përkatës ose gjykata;
- (e) Asnjë informacion identifikimi i një viktime apo personi që pretendon se ka vuajtur nga një vepër penale nuk duhet të reflektohet në materialin e përgatitur për publikim, përveç nëse viktima ka dhënë pëlqimin e tij/saj për këtë qëllim, kjo lejohet nga gjykata, ose viktima është figurë publike dhe vepra penale i është shkaktuar asaj për shkak të funksionit përkatës publik.

Përveç kësaj, gazetarët duhet të përdorin mjete efektive për të fshehur identitetin e individëve të përmendur në shkronjat (d) dhe (e) më sipër. Në veçanti, fytyra e individit dhe e çdo të afërmi, ose bashkëpunëtori të afërt të tij/saj, duhet të fshihet ose të bëhet ndryshe e paidentifikueshme, nëse shfaqet në të njëjtin imazh me individin në fjalë, ose në një imazh të veçantë që publikohet njëkohësisht.

II.2 Si t'i kuptojmë/zbatojmë përjashtimet

Kriteret e përjashtimit janë kumulative dhe zbatohen së bashku. Duhet të theksohet se përpunimi i të dhënave personale "me qëllim publikimi materialesh gazetarie" nuk nënkupton se një artikull duhet të publikohet domosdoshmërisht, në mënyrë që botuesi të përfitojë nga rregullat e përjashtimit. Mund të ketë raste kur informacioni personal mbliidhet dhe arkivohet me qëllim që të përdoret në një fazë të mëvonshme për qëllime (të identifikuar) gazetarie.

Përjashtimet zbatohen vetëm për përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie. Ky është një rregull imperativ.

Prandaj, një organizatë mediatike/gazetar i pavarur që përpunon të dhëna personale për qëllime të tjera nga ato të gazetarisë (p.sh., për qëllime administrative, burimesh njerëzore ose qëllime të tjera ekonomike), nuk mund të mbështetet në përjashtimet e sipërpërmendura.

Kjo do të thotë se, në rast përpunimi të të dhënave personale jo për qëllime gazetarie, ndaj organizatave mediatike/gazetarëve të pavarur zbatohen të njëjtat rregullat ligjore si për kontrolluesit e tjerë (jo media) (p.sh., shoqëritë tregtare, institucionet publike, etj.).

Gjithashtu, meqenëse përjashtimi për qëllime gazetarie rezulton të jetë një privilegj i organizatave profesionale të medias/gazetarëve të pavarur, informacioni personal i mbledhur, analizuar dhe raportuar/transmetuar/publikuar/etj., nga publiku i gjerë (nëpërmjet blogjeve/vlogjeve, llogarive të mediave sociale, etj.) – e ashtuquajtura gazetari qytetare – do të ishte vështirësisht i justifikueshëm bazuar në rregullat në fjalë të përjashtimit.

Kur mbështetemi në përjashtimin për qëllime gazetarie është e rëndësishme të peshohen me kujdes faktorët që e shpien gazetarin në përfundimin e arsyeshëm se një material i caktuar gazetarie (me interes publik) do të ndikohej negativisht në thelbin e tij, nëse do të respektohen detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Prandaj, nëse nuk ka asnjë mënyrë tjetër për të adresuar interesin publik (mbizotërues), përveçse duke shmangur detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave, rekomandohet që gazetarët të mbajnë shënime për çdo diskutim/arsyetim dhe komunikim me stafin epror redaksional dhe/ose nëpunësin për mbrojtjen e të dhënave (*data protection officer*) të organizatës mediatike përkatëse, me qëllim që të jenë në gjendje të vërtetojnë përpjekjet e tyre të ndershme për të respektuar të drejtën e mbrojtjes së të dhënave të një subjekti të caktuar, i cili është objekt i materialit përkatës të gazetarisë (p.sh., rasti i një personi publik). Sa më ndërhyrës dhe i dëmshëm të jetë një material gazetarie, aq më shumë vëmendje formale dhe materiale nevojitet nga stafi epror redaksional.

Shmangia e justifikuar e një detyrimi të caktuar, gjatë përgatitjes së një artikulli gazetaresk (p.sh., publikimi i të dhënave pa një kriter ligjor), nuk do të thotë domosdoshmërisht se duhen shmangur edhe detyrimet të tjera (p.sh., parimet e përpunimit). Prandaj, përjashtimi duhet të konsiderohet dhe vlerësohet me kujdes në dritën e të gjithë legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave.

Duke pasur parasysh se koha është e një rëndësie themelore në përditshmërinë e punës së gazetarëve (që do të thotë se një konsultim redaksional mund të mos jetë i mundur), do të ishte e këshillueshme të miratohen politika dhe kode të përshtatshme etike/sjelljeje (brenda një organizate mediatike ose në nivel industrie), të cilat mund t'i ndihmojnë gazetarët që të vlerësojnë dhe të vendosin, rast-pas-rasti, nëse do të mbështeten në përjashtimin për qëllime gazetarie, ose do të duhet të marrin në konsideratë të gjitha apo një pjesë të detyrimeve ligjore specifike lidhur me mbrojtjen e të dhënave/privatësisë.

Duhet të theksohet se ekziston një interes i përgjithshëm publik në vetë konceptin e lirisë së shprehjes. Megjithatë, thjesht justifikimi i përgjithshëm se të dhënat personale po përpunohen për qëllime gazetarie nuk është domosdoshmërisht i mjaftueshëm për të pajtuar/balancuar lirinë e shprehjes me të drejtën për mbrojtjen/privatësinë e të dhënave personale.

Prandaj, është e rëndësishme që të merren parasysh edhe rrethanat specifike rreth çdo veprimtarie përpunuese të dhënash, të cilat janë të qenësishme për përgatitjen e një materiali të veçantë gazetarie – *“interesi publik specifik”*.

Në këtë këndvështrim, një shqyrtim i plotë i çdo elementi pro ose kundër një publikimi gazetarie, në çdo rrethanë specifike, do t'i ndihmonte gazetarët të kryenin një vlerësim të arsyeshëm të balancës midis lirisë së shprehjes dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave/privatësi.

Faktorë të tillë përfshijnë: probabilitetin dhe shkallën e dëmit eventual ndaj individëve (ose ndonjë interesi tjetër publik); statusin e individit (p.sh., person privat ose publik); natyrën e informacionit të përpunuar dhe kontributin e tij të pritshëm në suaza të interesit publik; dhe nëse një informacion i tillë është tashmë publik (me kusht që ky publikim ekzistues nuk është në kundërshtim me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale).

Përveç sa më sipër, duhet theksuar se disa informacione/të dhëna nuk bien në fushën e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky përjashtim ligjor përfshin përpunimin e të dhënave personale të zyrtarëve publikë ose punonjësve të administratës publike, të cilat kanë të bëjnë rreptësisht me veprimtarinë e tyre publike, administrative, ose me situata/çështje që lidhen me angazhimet/detyrat e tyre (neni 4, pika 4b, e Ligjit për Mbrojtja e të dhënave personale).

Gjithashtu, të dhënat personale të personave të vdekur nuk përfshihen në fushën e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Megjithatë, në këtë rast, një vëmendje e arsyeshme duhet t'i kushtohet veçorive/elementeve të privatësisë së personave të vdekur që do të ndikonin në privatësinë e anëtarëve të familjes së tyre, të afërmve, të njohurve, etj.

III. RREGULLORJA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE (GDPR)

GDPR është instrumenti ligjor që rregullon përpunimin e të dhënave personale në Bashkimin Evropian. Kjo rregullore është një akt legjislativ detyrues, drejtpërdrejt i zbatueshëm, në tërësinë e tij, në të gjithë BE-në. Ajo përfaqëson pjesën më të rëndësishme të legjislacionit, të çdo shteti anëtar, për garantimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësi.

GDPR zbatohet për kontrolluesit/përpunuesit që ndodhen në BE, si dhe ata që ndodhen jashtë BE-së, të cilët plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

- ✓ Ofrojnë mallra ose shërbime për subjektin e të dhënave të vendosur në BE; ose
- ✓ Monitorojnë sjelljen e subjekteve të të dhënave të vendosur në BE.

Duhet theksuar se GDPR garanton të drejtën për mbrojtje të dhënash/privatësi të qytetarëve të BE-së, si dhe të atyre që nuk janë qytetar të BE-së, por që janë të vendosur/banojnë në BE.

Me fjalë të tjera, nëse një kontrollues, i themeluar/vendosur në Shqipëri, monitoron (p.sh., ndërvepron me ose përpunon të dhënat personale në mënyrë të njëanshme) sjelljet e një subjekti të dhënash që ndodhet/banon në BE, ky kontrollues duhet të veprojë në përputhje me rregullat e GDPR (*parimi i ekstraterritorialitetit*).

GDPR ka shfuqizuar Direktivën 95/46/KE, me të cilën Ligji Shqiptar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹ është plotësisht i përafëruar, duke sjellë në këtë mënyrë kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave në një nivel cilësisht më të lartë.

Disa nga risitë më të rëndësishme të GDPR në raport me Direktivën 95/46/EC (kupto gjithashtu: Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) përfshijnë si më poshtë:

- ✓ Parimin e ekstraterritorialitetit (siç shpjegohet më sipër).
- ✓ Parimin e përgjegjshmërisë. Ky është parimi kryesor i GDPR, sipas të cilit çdo kontrollues jo vetëm duhet të veprojë në përputhje me dispozitat e GDPR (p.sh., parimet e ligjshmërisë, saktësisë, minimizimit të të dhënave, ruajtjes së kufizuar në kohë, etj.),

¹ Shqipëria ka nisur procesin e përafërimit të legjislacionit vendas me GDPR. Në këtë kontekst, Komisioneri, në kuadër të një projekti konsulence të Delegacionit të BE-së, ka përgatitur, qarkulluar dhe publikuar për konsultim publik draftin e ligjit të ri, i cili synon përafërimit të plotë të legjislacionit vendas me dispozitat GDPR. Aktualisht drafti rezulton të jetë në një proces shqyrtimi dhe vlerësimi në Ministrinë e Drejtësisë.

por mban edhe barrën e provës për të demonstruar dhe evidentuar pajtueshmërinë me to.

- ✓ Dispozita/rregulla të dedikuara në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të të miturve (përfshirë kriteret për dhënien e pëlqimit).
- ✓ Prezantimin e kategorive të reja të të dhënave sensitive (të dhënat biometrike dhe gjenetike).
- ✓ Prezantimin e kategorive të reja të të drejtave të subjekteve të të dhënave (e drejta për t'u harruar dhe e drejta për transferueshmërinë e të dhënave).
- ✓ Shtimin e kërkesave lidhur me detyrimin e kontrolluesit për informimin e subjektit të të dhënave (për të dhënat e përpunuara drejtpërdrejt nga subjektet e të dhënave dhe ato të përpunuara nëpërmjet palëve të treta).
- ✓ Prezantimin e parimeve të *privacy by design* (që në projektim të një sistemi përpunimi) dhe *privacy by default* (si veprim i parazgjedhur në një sistem përpunimi). Këto parime nënkuptojnë detyrimin që çdo sistem përpunimi të dhënash personale duhet të projektohet për të trajtuar çdo çështje lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, duke përfshirë masa mbrojtëse të të dhënave si enkriptimet/pseudonimizimet, dhe se privatësia në këto sisteme duhet të jenë një opsion i parazgjedhur (automatikisht i aplikueshëm) në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave, si dhe të mos përpunohen më shumë të dhëna sesa është e nevojshme për të arritur qëllimin e përpunimit (*parimi i minimizimit të të dhënave*).
- ✓ Parashikimin e mekanizmave vetërregullues, si mekanizmi i certifikimit, kodet e sjelljes dhe rregullat e detyrueshme të korporatave (*binding corporate rules*) që zbatohen vetëm për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në vendet pa nivel të njaftueshëm mbrojtjeje të të dhënave.
- ✓ Parashikimin e detyrimit për të kryer një vlerësim të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave, përpara çdo veprimtarie përpunimi dhe/ose sa herë që kjo veprimtari ndryshon.
- ✓ Parashikimin e detyrimeve për regjistrimin veprimtarive të përpunimit të të dhënave që kryen një kontrollues.
- ✓ Parashikimin e rolit të detyrueshëm të nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave (*data protection officer – DPO*).
- ✓ Shtrëngimin e rregullave lidhur me transferimin ndërkombëtar të të dhënave.
- ✓ Zmadhimin i sanksioneve administrative deri në një maksimum të barabartë me 20 milionë euro, ose 4 për qind e xhiros globale vjetore të një kontrolluesi, cilado qoftë më e lartë.

Sa i përket përpunimit të të dhënave personale kundrejt lirisë së shprehjes, neni 85 (pika

1) i GDPR përcakton se është përgjegjësi e shteteve anëtare të BE-së të parashikojnë rregulla që pajtojnë të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale, siç parashikohet në GDPR, me lirinë e shprehjes dhe informimit, përfshirë përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie.

Duke e deleguar këtë detyrë ekskluzivisht te shtetet anëtare të BE-së, GDPR përcakton edhe perimetrin e përjashtimit të përpunimit të të dhënave për qëllime gazetarie, brenda të cilit shtetet anëtare duhet të veprojnë në këtë drejtim. Për këtë qëllim, neni 85 (pika 1) liston si derogime të mundshme, ndër të tjera, parimet e përpunimit (Kapitulli II), të drejtat e subjekteve të të dhënave (Kapitulli III), marrëdhëniet ndërmjet kontrolluesit dhe përpunuesit (Kapitulli IV), transferimin ndërkombëtar (Kapitulli V), etj.

Në këtë këndvështrim, GDPR nuk përmban dispozita specifike që rregullojnë në detaje derogimin e dispozitave për mbrojtjen e të dhënave personale, në favor të lirisë së shprehjes. Rregullorja ia akordon këtë ekskluzivitet shteteve anëtare, të cilat kanë treguar qasje të ndryshme në këtë drejtim.

Më poshtë paraqitet një vështrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor të përjashtimit/derogimit në disa shtete anëtare të BE-së:

Italia

Italia ka parashikuar disa parime në lidhje me përjashtimin e përpunimit për qëllime gazetarie, nëpërmjet miratimit të një kodi etik, i cili përfshin përjashtimin e së drejtës për informim të subjektit të të dhënave, si dhe për përpunimin e të dhënave sensitive pa pëlqim. Megjithatë, gazetari nuk mund të shkojë përtej elementeve thelbësore të informacionit të publikuar, me kusht që të ketë interes publik për vetë publikimin. Legjislacioni italian parashikon, gjithashtu, rregulla të rrepta për përpunimin e të dhënave personale të të miturve, të personave që vuajnë nga sëmundje të rënda ose terminale, të dhënave rreth jetës seksuale, etj.

Gjermania

Legjislacioni gjerman e përjashton kontrolluesin nga detyrimi për të fshirë të dhënat personale kur kjo është e pamundur, ose e mundur vetëm me përpjekje joproportionalish të mëdha dhe ku subjekti i të dhënave ka një interes të vogël për fshirje, si dhe kufizon të drejtat e subjekteve të të dhënave bazuar në kërkesa të caktuara ligjore.

Franca

Legjislacioni francez parashikon përjashtimin e përpunimit të të dhënave për qëllime gazetarie nga detyrimet në lidhje me informimin e subjektit të të dhënave, të drejtat e

subjektit të të dhënave, ruajtjen dhe përpunimin e kategorive të veçanta të të dhënave (të dhëna sensitive), etj.

Spanja

Legjislacionit spanjoll nuk parashikon dispozita specifike që adresojnë pajtimin e lirisë së shprehjes me mbrojtjen e të dhënave.

Suedia

Ligji suedez përcakton se GDPR dhe Akti për Mbrojtjen e të Dhënave (ligji kombëtar) nuk do të zbatohen në masën që dispozitat e tyre shkel legjislacionin për lirinë e shprehjes. Prandaj, dispozitat e GDPR lidhur, ndër të tjera, me parimet e përpunimit të të dhënave, kriteret ligjore të përpunimit, të drejtat e subjekteve të të dhënave, transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale, etj., nuk janë të zbatueshme për përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie.

Vështrim i posaçëm: Mbretëria e Bashkuar

Legjislacioni i Mbretërisë së Bashkuar përcakton se përpunimi i të dhënave personale nuk kufizohet nga detyrimet e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave, nëse plotësohen kriteret e mëposhtme kumulative:

- të dhënat personale përpunohen me qëllim publikimin e një materiali gazetarie;
- organi mediatik beson, në mënyrë të arsyeshme, se publikimi do të ishte me interes publik; dhe
- organi mediatik beson, në mënyrë të arsyeshme, se zbatimi i dispozitave për mbrojtjen e të dhënave është i papajtueshme me përpunimin për qëllime gazetarie.

Në çdo rast, interesi publik duhet të merret parasysh rast-pas-rasti, për arritur një balancë të tij me nivelin e ndërhyrjes në jetën private të një individi.

IV. KONKULZIONE/KËSHILLA TË RËNDËSISHME

Më poshtë janë renditur disa këshilla të rëndësishme që shërbejnë si përmbledhje e aspekteve të kryesore në lidhje me përputhshmërinë me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave. Është e rëndësishme të mbahen në konsideratë çështjet si vijon:

- ✓ Publikimi i të dhënave personale përbën një përpunim të dhënash, ndaj është thelbësore të siguroheni që keni lejen ose kriterin ligjor të nevojshëm për të bërë publike të dhënat e përpunuara. Pa një kriter ligjor të vlefshëm, kjo do të ishte e paligjshme.
- ✓ Nëse të dhënat personale përpunohen për qëllime gazetarie (në shërbim të interesit publik), ato mund të përjashtohen nga disa dispozita të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe GDPR. Në të kundërt, nëse të dhënat personale mbledhen, analizohen ose përpunohen për arsye të tjera, do të zbatohen plotësisht dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe GDPR.
- ✓ Publikimi i të dhënave sensitive mund të dëmtojë potencialisht jetën private të një individi. Është e rëndësishme të vlerësohet me kujdes nëse interesi publik e justifikon këtë dëm. Kjo përfshin balancimin e interesave në rrezik, si dhe marrjen parasysh të nivelit të ndërhyrjes në jetën private të subjektit të të dhënave. Një informacion i tillë mund të publikohet vetëm kur interesi publik prevalon qartësisht ndaj shqetësimeve rreth privatësisë.
- ✓ Përfshirja e stafit epror redaksional ose kërkimi i mendimit të ekspertëve (p.sh., nga nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave të organizatës mediatike) mund të jetë i dobishëm për sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat ligjore për mbrojtjen e të dhënave. Është e rëndësishme të mbahet parasysh se gazetarët e përfshirë në përgatitjen e një artikulli mund të mos jenë gjithnjë plotësisht objektivë kur përpiqen të balancojnë interesa të ndryshme rreth artikullit të përgatitur.
- ✓ Mbledhni vetëm të dhëna që janë me interes publik për punën/investigimin gazetaresk. Për shembull, nëse jeni duke investiguar një politikan për korrupsion të mundshëm, zbulimi i informacioneve delikate në lidhje me orientimin e tij seksual, i cili nuk është i rëndësishëm për objektin e investigimit, mund të përbëjë shkelje të drejtës për mbrojtjen e të dhënave. Ky parim përputhet me konceptin e minimizimit të të dhënave, një element kyç i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe GDPR.
- ✓ Në rastet veçanërisht të diskutueshme, kur është e paqartë nëse, ose në çfarë mase, përjashtimi i përpunimit për qëllime gazetarie zbatohet për përpunimin e të dhënave, konsultimi me autoritetin mbikëqyrës (Komisionerin) mund të jetë burim qartësie lidhur me detyrimet për mbrojtjen e të dhënave.

- ✓ Duhet të merren masa paraprake të veçanta kur përpunoni të dhëna personale me natyrë sensitive.
- ✓ Të dhënat në lidhje me personat vulnerabël, veçanërisht të miturit, duhet të përpunohen vetëm nëse ka arsye të forta, specifike, në thelb të përpunimit përkatës për qëllime gazetarie. Është thelbësore të sigurohet se ekzistojnë justifikime të tilla përpara se të vijohet me përpunimin të të dhënave.
- ✓ Është e domosdoshme që të jeni gjithmonë në gjendje të demonstroi përputhshmëri me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave (*parimi i përgjegjshmërisë*). Për këtë qëllim, ruani rekorde të mendimeve, diskutimeve, komenteve të shkëmbyera me kolegët, stafin epror redaksional dhe nëpunësin e mbrojtjes së të dhënave të organizatës, në lidhje me përpjekjet për të harmonizuar të drejtën e lirisë së shprehjes me atë të mbrojtjes së të dhënave/privatësisë. Përdorni lista kontrolli (*checklists*) për këtë qëllim dhe qëndroni gjithnjë brenda perimetrit të tolerancës dhe balancës së parashikuar në kodet e sjelljes dhe politika të tjera etike të zbatueshme për organizatën tuaj.



PËRMBLEDHJE POLITIKASH:

Rregullat për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave nga mediat dhe gazetarët në Shqipëri

Qershor 2023

© Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative në Shqipëri (Balkan Investigative Reporting Network in Albania - BIRN)
Tiranë, 2023